

# Fitonasal Pediatric

AL

## Dekongjestionon dhe mbron mukozën

### SPRAY NEBULIZATOR ME VEPRIM DEKONGJESTIONANT JO-FARMAKOLOGJIK

Ideal në rast të:

- Kongjestionimit të hundës
- Kollës që shfaqet pas ftohjes

SOLUCION I BALANCUAR HIPERTONIK DHE I STANDARDIZUAR



Me **Tannisal**  
kompleks molekular natyral i  
Tanineve dhe Kripës së gurit

### PAJISJE MJEKËSORE Klasa Ila

**Fitonasal Pediatric** është një **dekonjestionant inovativ** formuluar posaçërisht për të liruar hundën në rast të bllokimit dhe irritimit të zgavrave të hundës për shkak të sindromave të gripit, ftohjes së zakonshme, rinitit alergjik dhe sinusitit si akut ashtu edhe kronik.

**Fitonasal Pediatric** vepron në sajë të **TANNISAL**, një kompleksi molekular natyral i tanineve dhe kripës së gurit, që ndërvepron me mukozën e hundës duke kryer:

**1. Një veprim dekonjestionant me një mekanizëm të dyfishtë jo-farmakologjik**

- **Precipitimi i bradikininës:** taninet që përmbahen në produkt janë në gjendje të lidhin këtë ndërmjetës të inflamacionit duke reduktuar kështu kongjestionin e hundës;
- **Osmolaliteti i balancuar dhe i standardizuar** (600 mOsm/kg) që lehtëson tërheqjen e ujit nga indet e kongjestionuara pa irrituar dhe tharë mukozën.

**2. Një veprim mbrojtës**

- Që normalizon mukozën e hundës në sajë të adezionit të substancave aktive dhe të veprimit efikas të tyre antioksidues.

Përveç kësaj, produkti, në sajë të spërkatësit të tij të nebulizuar me fluks të vazhdueshëm, ka një veprim të **thellë pastrimi të zgavrave të hundës që heq mukusin e tepërt dhe agjentët patogjenë, irritues dhe alergjizuesit** e bllokuar në të (virusë, baktere, tym, smog, polene, substanca irituese, etj.). **Ky veprim është veçanërisht i dobishëm tek foshnja që nuk është në gjendje të fryjë hundën dhe të fëmija që nuk e bëjnë atë në mënyrë të përshtatshme.**

Për këto karakteristika **Fitonasal Pediatric**, është veçanërisht i përshtatshëm në rastin e **kollës retro-nazale**. Në fakt, mbetja e mundshme e mukusit në zgavrat e hundës dhe prania e mikroorganizmave dhe substancave alergjizuese, nëpërmjet shkarkimit retro-nazal, mund të jenë shkak i kollës apo probleme të tjera si **dhimbje fyti dhe infeksion i veshit të mesëm**. **Fitonasal Pediatric** nuk përmban dekonjestionantë vazokonstriktorë dhe, në sajë të mekanizmit të tij inovativ me veprim jo-farmakologjik nuk krijon varësi, nuk e than mukozën e hundës, nuk irriton dhe mund të përdoret shpesh, edhe për periudha të gjata. Përdorimi i produktit tek foshnjat dhe fëmijët ndihmon frymëmarrjen dhe lehtëson pushimin gjatë natës.


**PAKETIMI: Fitonasal Pediatric** paraqitet në një enë me spërkatës spray të pajisur me teknologji **"bag on valve"** (BOV) që është pjesë integrale e efikasitetit të produktit dhe që për këtë arsye ofron përparësi të shumta:

- **Prakticitet** - teknologjia BOV lejon një **shpërndarje me fluks të vazhdueshëm** dhe në **të gjitha pozicionet**, veçanërisht i dobishëm në vitet e para të jetës;
- **Ergonomicitet** - çepi shpërndarës është menduar që t'i përshtatet edhe hundës së më të vegjëlve;
- **Cilësi** - produkti gjendet në një qese të izoluar nga jashtë, në mënyrë që të lejojë daljen, por jo rifutjen e ajrit, lëngjeve ose mbetjeve të tjera;
- **Mbrojtje të ambientit** - Përmban gaz propelen (Azot) i cili respekton shtresën e ozonit.

**UDHËZIME: Fitonasal Pediatric** përdoret në të gjitha rastet e bllokimit dhe irritimit të zgavrave të hundës për shkak të sindromave të gripit, ftohjes, rinitit alergjik dhe sinusitit si akut ashtu edhe kronik. Mund të përdoret gjithashtu si trajtim ndihmës në raste të kollës, dhimbjes së fytyrë të shkaktuar nga shkarkimi retro-nazal dhe infeksione të veshit të mesëm që shkaktohen nga bllokimi i hundës. Ideal për përdorim të shpeshtë. Produkti udhëzohet të merret nga mosha 6 muajsh e sipër.

**MËNYRA E PËRDORIMIT:** të përdoret të paktën **2 herë në ditë**, në mënjësi dhe në mbrëmje dhe sa herë që vlerësohet se është e nevojshme. Për një veprim efikas dekonjestionant dhe mbrojtës të mukozës përdorni **Fitonasal Pediatric** siç udhëzohet më poshtë:

#### Nga mosha 6 muajsh deri në një vit



1. Shtrijeni fëmijën anash dhe futni spërkatësin në vrimën e sipërme të hundës, spërkatni produktin.

2. Përsëriteni veprimin në vrimën tjetër të hundës, duke e shtrijë fëmijën në anën tjetër.

#### Mbi një vjeç



1. Vendosni spërkatësin në vrimën e hundës dhe ushtroni pak presion për disa sekonda.

2. Pastroni hundën ose, nëse është e mundur, fryni hundët dhe përsëritni spërkatjen në vrimën tjetër të hundës.

Pas çdo përdorimi, fshijeni spërkatësin me një leckë të lagur të pastër dhe thajeni me kujdes. **Me një çep komfort të përshtatshëm edhe për hundën e më të vegjëlve.**

**PËRBËRJA - Substancat funksionale: TANNISAL**, kompleksi molekular natyral i standardizuar i përbërë nga: një fraksion taninësh nga Hamamelis dhe Kripë e gurit (kripë minerale e patrajtuar kimikisht). **Përmban gjithashtu:** Ujë, Glicerinë vejetale, Lëng limoni, Nahkolit (Bikarbonat natriumi natyral).

**PARALAJMËRIME:** nuk duhet përdorur nëse keni mbindjeshmëri ose alergji individuale ndaj një ose më shumë përbërësve. Në qoftë se simptomat vazhdojnë, këshillohuni me një mjek. Të përdoret vetëm nga hunda. Të shmangët kontakti me sytë. Në rast se ndodh lajmi me ujë.

**Kujdes** - Enë me presion: mund të shpërthojë nëse nxehtë. Të mos shpohet dhe as digjet edhe pas përdorimit. Të mbahet larg burimeve të nxehtësisë, sipërfaqeve të nxehta, shkëndijave, flakëve të lira ose burimeve të tjera të ndezjes. Mos pini duhan. Të mbrohet nga rrezet e diellit. **Të mos ekspozohet ndaj temperaturave që tejkalojnë 50° C/122° F.** Të mbahet larg fëmijëve. Të ruhet në vend të freskët, të thatë, larg burimeve të nxehtësisë dhe të mbrohet nga drita. Data e skadimit i referohet produktit të paprekur dhe të ruajtur në mënyrë korrekte.

**SKADIMI:** shihni datën e shtypur mbi ambalazh. Mos e përdorni pas datës së skadimit të paraqitur. Data e skadimit e treguar në paketim mbetet e pandryshuar edhe pas spërkatjes së parë.

**KONFEKSION SHITJE:** spray nebulizator prej 125 ml.

**DATA E REVIZIONIMIT TË FUNDIT:** 12/2019



#### PËR SHËNDETIN SOT DHE NESËR

Aboca është një Shoqëri Benefit dhe është e certifikuar B Corp.

Ne jemi të përkushtuar të veprimë në një mënyrë të përgjegjshme, të qëndrueshme dhe transparente ndaj komunitetit dhe ambientit. Relacioni i ndikimit është i disponueshëm në faqen e internetit [www.aboca.com](http://www.aboca.com)

**100% natyral dhe i biodegradueshëm**, Fitonasal Pediatric nuk përmban substanca sintetike, gjysmë sintetike ose të modifikuara gjenetiksht.

MATERIALE AMBALAZHIMI		
Paketim	PAP 21	> Letër
Fletëpalosje	PAP 22	> Letër
Bombol me spërkatës	C/ALU 90	> Kryesisht alumin
Tapë	PP 5	> Plastikë
Për eliminimin, verifikoni dispozitat në zonën tuaj të banimit.		

**Aboca S.p.A. Società Agricola**  
Loc. Aboca, 20 - 52037 Sansepolcro (AR) - Italia  
[www.aboca.com](http://www.aboca.com)

Ndërmarrje me sistem të administrimit të cilësisë ISO 9001 e ISO 13485 dhe sistem të administrimit ambiental ISO 14001 të certifikuar.



# Fitonasal Pediatric

## Decongests and protects the mucosa

### NEBULISER SPRAY WITH A NON-PHARMACOLOGICAL DECONGESTANT ACTION

Ideal for:

- Nasal congestion
- Coughs resulting from a cold

BALANCED AND STANDARDISED HYPERTONIC SOLUTION



With **Tannisal**  
natural molecular complex  
of Tannins and Rock Salt



### MEDICAL DEVICE Class IIa

**Fitonasal Pediatric** is an **innovative decongestant** specially formulated to unblock the nose in cases of congestion and irritation of the nasal cavities caused by flu-like illnesses, the common cold, allergic rhinitis and both acute and chronic sinusitis.

**Fitonasal Pediatric** works thanks to **TANNISAL**, a natural molecular complex of tannins and rock salt, which interacts with the nasal mucosa to provide:

1. **A decongestant action with a dual non-pharmacological mechanism**
  - **Precipitation of bradykinin:** the tannins contained in the product are able to bind to this inflammatory mediator, thus reducing nasal congestion;
  - **Balanced and standardised osmolality** (600 mOsm/kg), which helps water to be drawn back from the congested tissues, without irritating or drying the mucosa.
2. **Protective effect**
  - that normalises the nasal mucosa thanks to the adhesive properties of the active substances and their effective antioxidant action.

Moreover, thanks to the product's continuous nebulised spray, it performs a **deep cleansing of the nasal cavities, removing excess mucus and the pathogens, irritants and allergens** trapped within it (*viruses, bacteria, smoke, smog, pollen, irritants, etc.*). **This action is particularly helpful for infants who are unable to blow their noses and children who do so inadequately.** Thanks to these characteristics, **Fitonasal Pediatric** is especially indicated in cases of **cough caused by post-nasal drip**. In fact, the build-up of mucus in the nasal cavities and the presence of microorganisms and allergenic substances can, as a result of post-nasal drip, cause cough or other problems such as **sore throat and otitis media**.

**Fitonasal Pediatric** does not contain vasoconstrictive decongestants and, thanks to its innovative non-pharmacological mechanism of action, does not create dependency, does not dry out the nasal mucosa, is non-irritating and can be used frequently, even over prolonged periods. When used in infants and children, the product aids breathing and makes it easier to sleep at night.

**PACKAGE:** **Fitonasal Pediatric** comes in a container featuring a spray dispenser with **"bag-on-valve"** (BOV) technology, which is an intrinsic element of the product's effectiveness, offering a variety of benefits:


- **Easy to use** - BOV technology enables a **continuous-flow spray in all positions**, which is particularly helpful for very young children;
- **Ergonomic** - the spray nozzle has been designed to fit the noses of even very small children;
- **Quality** - the product is contained inside a bag that is isolated from the external environment. This allows the product out, but does not allow air, liquids or other residues back in;
- **Environmental protection** - Contains nitrogen, a propellant which respects the ozone layer.

**INDICATIONS:** **Fitonasal Pediatric** is indicated in all cases of congestion and irritation of the nasal cavities caused by flu-like illnesses, colds, allergic rhinitis and both acute and chronic sinusitis. It can also be used as an adjuvant treatment in cases of cough, sore throat caused by post-nasal drip, and otitis media resulting from nasal congestion. Ideal for frequent use.


The product is indicated for children from 6 months and up.

**INSTRUCTIONS FOR USE:** use at least **twice a day**, morning and evening, and any time you feel it is necessary. For an effective decongestant and protective action on the mucosa, use **Fitonasal Pediatric** as follows:

#### From 6 months to 1 year of age



#### Over 1 year of age



After each use, clean the nozzle with a clean, damp cloth and dry it thoroughly. **Features a comfort nozzle - suitable even for very young children's noses.**

**COMPOSITION - Functional substances:** **TANNISAL**, a standardised, natural, molecular complex composed of: a tannic fraction from Witch Hazel and Rock Salt (chemically untreated, mined salt). **Also contains:** Water, Vegetable glycerin, Lemon juice, Nahcolite (Natural sodium bicarbonate).

**WARNINGS:** do not use in case of individual hypersensitivity or allergy to one or more components. If symptoms persist, seek medical advice. For nasal use only. Avoid contact with the eyes. If contact occurs, rinse with water.

**Warning** - Pressurised container: may burst if heated. Do not pierce or burn, even after use. Keep away from heat, hot surfaces, sparks, open flames and other ignition sources. No smoking. Protect from sunlight. **Do not expose to temperatures exceeding 50°C/122°F.** Keep out of reach of children.

Store in a cool, dry place, away from heat sources and protected from light. The expiry date refers to the intact product, stored correctly.

**EXPIRY DATE:** see the expiry date stated on the pack. Do not use after the expiry date indicated. The expiry date indicated on the pack remains the same even after the first use.

**PACK FOR SALE:** 125 ml nebuliser spray.

**LAST REVISION DATE:** 12/2019



#### FOR TODAY AND TOMORROW'S HEALTH

Aboca is a Benefit Corporation and certified B Corp.

We are committed to operating responsibly, sustainably and transparently towards the community and the environment. Impact report available at [www.aboca.com](http://www.aboca.com)

**100% natural and biodegradable**, **Fitonasal Pediatric** does not contain synthetic, semi-synthetic or genetically modified substances.

PACKAGING MATERIALS	
Carton box	PAP 21 > Paperboard
Leaflet	PAP 22 > Paper
Spray can with nozzle	C/ALU 90 > Predominantly aluminium
Cap	PP 5 > Plastic
<b>For disposal, please check the regulations in your local area.</b>	

**Aboca S.p.A. Società Agricola** - Loc. Aboca, 20 - 52037 Sansepolcro (AR) - Italia - [www.aboca.com](http://www.aboca.com)

Company operating under certifications ISO 9001 and ISO 13485 for quality management system and ISO 14001 for environmental management system.

Certified



130004173/01